

**SHËNIMET SHPJEGUESE PËR PASQYRAT FINANCIARE TË AKTIVITETIT TË MBYLLUR
TË VITIT PËR SHOQËRINË TREGTARE "SPARTAK S.A" SH.P.K.**

**A) DISA SQARIME NË LIDHJE ME SHËNIMET SHPJEGUESE PËR BILANCIN
E VITIT 2020**

Dhënia e shënimeve shpjeguese në këtë pjesë është e detyrueshme sipas SKK 2. Shënime shpjeguese në këtë bilanc japin përshkrime me fjalë ose zbërthime të zërave të paraqitura në këto pasqyra dhe informacione rreth zërave që nuk kualifikohen për njohje në këto pasqyra.

Në këto Shënime shpjeguese ne japim: (a) informacione në lidhje me bazën e përgatitjes së pasqyrave financiare dhe politikat specifike kontabël të përdorura; (b) informacion shpjegues të kërkuar nga Standardet Kombëtare të Kontabilitetit i cili nuk është paraqitur diku tjetër në pasqyrat financiare; dhe (c) informacion që nuk është paraqitur diku tjetër në pasqyrat financiare por është i nevojshëm për të kuptuar ndonjë prej tyre.

Kjo njësi ekonomike normalisht i paraqet shënime shpjeguese në rendin e mëposhtëm:

- A). Një deklaratë që pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit;
- B). Një përmbledhje të politikave kontabël të rëndësishme të zbatuara;
- C). Informacion mbështetës për zërat e paraqitur në pasqyrat financiare, në rendin në të cilin paraqitet çdo pasqyrë dhe zë përkatës;
- D). Shënime të tjera shpjeguese.

NJËSIA ECONOMIKE JEP INFORMACIONE PËR ÇËSHTJET E MËPOSHTME:

A). Dhënia e informacioneve shpjeguese nga kjo njësi ekonomike për politikat kontabël.

Kjo njësi ekonomike në këto shënime shpjeguese jep informacion shpjegues në vijim për përmbledhjen e politikave të rëndësishme kontabël që janë:

- a). Baza e matjes (ose bazat) të përdorura në përgatitjen e pasqyrave financiare;
- b). Politikat e tjera kontabël të përdorura, të rëndësishme për kuptimin e pasqyrave financiare.

B). Dhënia e Informacioneve në lidhje me burimet kryesore të pasigurisë së vlerësimit.

Njësia ekonomike **"SPARTAK S.A" SH.P.K** Ka dhënë dhe mund të japë informacione në shënime shpjeguese rreth supozimeve kyçe lidhur me të ardhmen, dhe burime të tjera kryesore të pasigurisë së vlerësimit në datën e raportimit, të cilat ka shumë mundësi të sjellin një rregullim material në vlerat kontabël neto të aktiveve dhe detyrimeve brenda vitit të ardhshëm financiar. Përsa i përket këtyre aktiveve dhe detyrimeve, shënime shpjeguese përfshijnë detajet për:

- a) Natyrën e tyre;
- b) Vlerën e tyre kontabël në fund të periudhës raportuese.

Dhënia e Informacioneve në lidhje me "Palët e lidhura" dhe Shpjegime për këto palë.

Njësia ekonomike **"SPARTAK S.A" SH.P.K** konsiderohet si e lidhur, me një palë tjetër nëse njëra palë ose kontrollon palën tjetër, ose ka një ndikim të ndjeshëm mbi palën tjetër. Ndikimi i ndjeshëm ekziston kur ajo lidhet me vendimet financiare dhe ato të shfrytëzimit. Palët janë të lidhura edhe kur ato janë nën kontrollin e përbashkët të një njësie tjetër. Ekzistenca e kontrollit, kontrollit të përbashkët ose ndikimit të ndjeshëm mund të ndikojnë mbi mënyrën se si të dyja palët hyjnë në aktivite biznesi me njëra-tjetrën. Prandaj, për t'i kuptuar sa më mirë pasqyrat financiare të një njësie ekonomike, duhet të kuptohen mirë marrëdhëniet dhe kushtet, në të cilat palët e lidhura hyjnë në aktivite biznesi me njëra-tjetrën. Shembuj të palëve të lidhura përfshijnë: (a) njësia mëmë (dhe personat që kontrollojnë ose kanë ndikim të ndjeshëm mbi njësinë mëmë); (b) njësitë e kontrolluara; (c) pjesëmarrjet; (d) sipërmarrje të tjera të të njëjtit grup konsolidimi (për shembull, njësitë e kontrolluara simotra); (e) drejtuesit, anëtarët e organit mbikëqyrës si dhe aksionarët që zotërojnë një pjesë të konsiderueshme të aksioneve, me përjashtim të atyre rasteve kur këta persona nuk e kanë mundësinë praktike të ushtrojnë influencë të ndjeshme mbi vendimet ekonomike të njësisë ekonomike raportuese; (f) të afërmit e ngushtë të personave të përmendur në pikën (e) (përfshirë këtu personat e afërt dhe fëmijët) si dhe njësitë ekonomike që janë nën kontrollin ose ndikimin e tyre. Njësia ekonomike **"SPARTAK S.A" SH.P.K** nuk është e lidhur me ndonjë palë tjetër.

1

Përveç kërkesave të këtij standardi çdo standard tjetër i SKK-ve kërkon dhënie informacionesh shpjeguese përkatëse. Plotësimi i te dhenave të kësaj pjese është bërë sipas kërkesave dhe strukturës standarde të përcaktuar në SKK 2 dhe në SKK-të e tjera 3-14 dhe konkretisht, rradha e dhënies së shpjegimeve është si vijon:

- a) *Informacion i përgjithshëm dhe politikat kontabël.*
- b) *Shënime të shpjegojnë zërat e ndryshëm të pasqyrave financiare.*
- c) *Shënime të tjera shpjeguese.*

B) INFORMACION I PËRGJITHSHËM PËR PASQYRËN E PERFORMANCËS TË HARTUAR NË MBYLLJE TË AKTIVITETIT EKONOMIK E FINANCIAR TË KRYER GJATË VITIT 2020

Kuadri ligjor:

Ligji nr. 25/2018 dt 10.05.2018 "Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare"

Kuadri kontabël i aplikuar:

Standardet Kombëtare të Kontabilitetit në Shqipëri (SKK 2; 49).

Baza e përgatitjes së PF-ve:

Të drejtat dhe detyrimet e konstatuara (SSK 1, 35).

Parimet dhe karakteristikat cilësore të përdorura për hartimin e PF-ve: (SKK 1; 37 - 69).

- a) NJËSIA EKONOMIKE RAPORTUSE 'SPARTAK S.A.' SH.P.K mban në llogaritë e saj aktivet, pasivet dhe ka raportuar të gjitha trasaksionet
- b) VIJIMËSIA e veprimtarisë ekonomike të njësisë sonë raportuese është e realizuar duke siguruar vazhdimësi dhe duke mos pasur në plan ose nevojë për ndërprerjen e aktivitetit të saj.
- c) KOMPENSIMI midis një aktivi dhe një pasivi është bërë në rastin kur personi juridik ose fizik paraqitet si klient dhe si furnitor njëkohësisht vetëm në rastet që lejohen nga SKK-të.
- d) KUPTUESHMËRIA e Pasqyrave Financiare është realizuar në masën e plotë në mënyrë që informacioni i paraqitur të jetë i standartizuar, i qartë dhe i kuptueshëm për përdorues që kanë njohuri të përgjithshme dhe të mjaftueshme në fushën e kontabilitetit.
- e) MATERIALITETI është vlerësuar nga ana jonë dhe në bazë të tij, Pasqyrat Financiare janë të hartuara vetëm për zëra materiale.
- f) BESUESHMËRIA. Hartimi i Pasqyrave Financiare është e siguruar nëpërmjet punës së kujdesshme duke ruajtur vijimësinë me kusht që të gjithë zërat e bilancit të jenë materiale duke respektuar kërkesat e SKK-ve. Për ndërtimin e Pasqyrave Financiare me të gjithë elementët e prezantuar në to, si kërkesa bazë, kanë qenë dhe mbeten zbatimi i SKK-ve.

Politikat kontabël

Pasqyrat Financiare të vitit 2020 janë ndërtuar sipas SKK ve - referuar nenit 4 të Ligjit nr. 25/2018 datë 10.05.2018 "Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare". Në ndërtimin e Pasqyrave Financiare ndryshojnë formatet e BK e të PASH sepse janë zbatuar kërkesat e SKK 2. Shifrat e vitit 2020 janë bërë të krahasueshme me ato të vitit paraardhës 2009-2019. Për realizimin e kësaj detyre janë bërë të gjitha rregullimet e mundshme me qëllim që informacioni kontabël të krahasohet në dinamikë.

Lista e llogarive e përdorur për vitin 2020 është ajo e publikuar nga "Këshilli Kombëtar i Kontabilitetit" dhe është e përshtatur për zbatimin sa më të plotë të SKK-ve gjatë vitit 2020.

Për mbajtjen e inventarëve janë përcaktuar metodat e inventarizimit dhe mënyra e vlerësimit të tyre, me qëllim që të jenë të plotësuar kërkesat e SKK 4, 15 dhe konkretisht:

- a) Për lëndët e para, për produktet e gatshme dhe për mallrat, është përdorur mënyra e inventarizimit të vazhdueshëm ndërsa vlerësimi i tyre është bërë me metodën "Vlerësim me kosto mesatare të ponderuar".
- b) Për artikujt ushqimorë është përdorur inventarizimi i ndërmjetëm bazuar në metodën e "Vlerësimit me kosto mesatare të ponderuar "SKK 4, 15".

Vlerësimi fillestar i një elementi të AAM-ve që plotëson kriteret për njohje si aktiv në bilanc është bërë me koston e plotë (SKK 5; 11). Për prodhimin ose krijimin e AAM-ve kur kjo financohet nga një

hua, kostot e huamarrjes deri në përfshirjen e aktivitetit plotësisht në bilanc (plus interesat) kapitalizohen në koston e aktivitetit vetëm për periudhën e investimit deri në përfundimin e tij (SKK 5:16).

Më pas, kur AAM-ja është marrë në kontabilitet si i tillë, interesat dhe kostot e tjera të huamarrjeve i janë ngarkuar rezultatit të vitit ushtrimor të aktivitetit duke u bazuar në të dhënat konkrete të amortizimit të kredive të marra nga njësitë ekonomike.

Për vlerësimin e mëpasshëm të një AAM-je është zgjedhur modeli i koston fillestare të fiksuar duke e paraqitur në bilanc me kosto minus amortizimin e akumuluar (SKK 5; 21).

Për llogaritjen e amortizimit të AAM-ve (SKK 5: 38) janë përdorur metodat e pranuar nga Ligji për "Tatimin mbi të ardhurat" ku si metodë e amortizimit të ndërtesave përdorim metodën lineare mbi vlerën e mbetur, por edhe për AAM-të e tjera përdorim metodën lineare të llogaritjes së shpenzimeve të amortizimit mbi bazën e vlerës së mbetur të AAM-ve. Normat e amortizimit janë të njëjta me ato të pranuar nga sistemi fiskal në fuqi dhe konkretisht:

- Për ndërtesat në mënyrë lineare mbi vlerën e mbetur deri në 5% në vit.
- Për kompjutera e sisteme informacioni deri në 25% të vlerës së mbetur.
- Për të gjitha AAM-të e tjera deri në 20% të vlerës së mbetur.

Mbajtja e kontabilitetit është realizuar në mënyrë kompjuterike me programin ALPHAWEB. Dhënia e shënimeve shpjeguese në këtë pjesë është e detyrueshme sipas SKK 2. Shënimet shpjeguese në këtë bilanc japin përshkrime me fjalë ose zbërthime të zërave të paraqitura në këto pasqyra dhe informacione rreth zërave që nuk kualifikohen për njohje në këto pasqyra.

Shënimet shpjeguese japin: (a) informacione në lidhje me bazën e përgatitjes së pasqyrave financiare dhe politikave specifike kontabël të përdorura; (b) informacion shpjegues të kërkuar nga Standardet Kombëtare të Kontabilitetit i cili nuk është paraqitur diku tjetër në pasqyrat financiare; dhe (c) informacion që nuk është paraqitur diku tjetër në pasqyrat financiare por është i nevojshëm për të kuptuar ndonjë prej tyre.

C) SHPJEGIME DHE KOMENTE PËR TREGUESIT E VENDOSUR NË PASQYRAT FINANCIARE TË HARTUARA PËR AKTIVITETIN TREGTAR TË KRYER GJATË VITIT 2020

Aktivitetet monetare në masën **265,263** lekë përbëjnë Mjetet Monetare të cilat ndodhen në llogaritë bankare dhe në arkë. Gjendja në Arkë është vetëm **207,967** lekë, ndërsa gjendja në bankë është diferenca e përcaktuar në llogaritë analitike bankare në tabelën përkatëse. Rezultatet konkrete jepen në pasqyrën shoqëruese për këto shënime bashkëngjitur këtij materiali. Aty janë dhënë konkretisht llojet e monedhave dhe llojet e llogarive në monedha të ndryshme për Bankat dhe për Arkën.

Llogaritë e Kërkesave të Arkëtueshme përbëjnë një burim të rëndësishëm të sigurt për vazhdimin normal të biznesit. Kërkesat e Arkëtueshme janë në masën **16,886,478** lekë dhe përbëhen nga shumë klientë. Kurse vlera **157,563,495** lekë përbën marrëdhënie të shoqërisë me Debitorë të Tjerë, kryesisht institucione shtetërore si Gjykata Administrative Korçë dhe shoqëri të tjera si pagesa për garanci, dhe vlera në debi e TVSH në masën **481,337** lekë.

Detyrimet ndaj furnitorëve në periudhë afatshkurtër janë në masën **26,413,092** lekë. Parapagimet e marra nga Trema Engineering 2 Sh.p.k përbëjnë vlerën **6,425,244** lekë. Detyrimet për pagat e punonjësve janë në masën **4,403,843** lekë, për Sigurimet Shoqërore e Shëndetsore dhe për Tatimin mbi Pagën janë në masën **226,821** lekë, Detyrimi për Tatimin në Burim është në masën **331,500** lekë dhe Detyrimi për Tatim Fitimin për Vitin 2020 është në masën **97,375** lekë.

Ndërsa Detyrimet Afatgjata përbëhen nga Principali i kredisë në Lekë në Intesa SanPaolo Bank në masën **29,193,763** lekë.

Në lidhje me Inventarët dhe Mallrat për rishitje, ne po ju paraqesim gjendjet dhe lëvizjet e Magazinave të Lëndëve të Para dhe të Mallrave të cilat i bashkëngjiten materialit. Në këtë magazinë janë vendosur si Mallrat për Shitje edhe Aktivitetet Afatgjata Materiale AAM.

Për Aktivitetet Afatgjata Materiale janë zbatuar kërkesat e SKK 5: 90, 91, 92, 93 të cilat janë të shprehura në pasqyrat që i bashkëngjiten materialit. Konkretisht janë dy tabela. Njëra shpreh llojshmërinë

dhe vlerën fillestare për secilin aktiv në momentin e marrjes në kontabilitet kurse tjetra shpreh Amortizimin e Akumuluar dhe Amortizimin e llogaritur të AAM-ve sipas grupeve. Gjithashtu këtu jepen edhe hyrje, daljet e aktiveve në grupe gjatë vitit, të cilat përbëjnë ato që quhen ndryshime në Inventarin e Aktiveve Afatgjata Materiale. Gjatë Vitit 2020 shoqëria ka investuar në **425,700** lekë investime të reja. Për këtë shoqëri për vitin 2020 si Shpenzim është llogaritur **3,601,985** lekë amortizim.

Gjithë Kapitali i shoqërisë “SPARTAK S.A” SH.P.K është i përcaktuar saktë nëpër llogaritë përkatëse. Shprehemi se pjesët e Kapitalit përbëjnë Kapitali i Nënshkruar në masën **140,000,000** lekë, Rezervat në masën **22,000,000** lekë, të cilat këtu ndahen në Rezerva Ligjore, Statutore dhe Rezerva të tjera, Fitime të pashpërndara në masën **9,289,203** lekë që kanë për burim fitimin e akumuluar në vite dhe Fitimi i vitit ushtrimor në masën **3,596,858** lekë, që ka si burim aktivitetin në vite të cilat janë të patatuara me dividend. Kjo shoqëri nuk ka shpërndarë asnjë vit dividend.

Për të analizuar të dhëna më të hollësishme për secilin zë të Bilancit dhe për të gjetur ndikimin e faktorëve në nivelin e treguesve bazë, duhet t’i referohemi gjendjes së llogarive në materialet bashkëngjitur dhe më tej kartelës për secilën llogari.

D) SHPJEGIME DHE KOMENTE PËR TREGUESIT E VENDOSUR NË “PASQYRËN E TË ARDHURAVE DHE TË SHPENZIMEVE PËR VITIN 2020”.

PASH është paraqitur për të ardhura dhe shpenzime sipas natyrës në të gjithë elementët përbërës të saj. Të ardhurat janë përfitimet ekonomike bruto, të marra gjatë periudhës kontabël, si rezultat i rrjedhës normale të veprimtarisë së njësisë ekonomike raportuese, atëherë kur këto përfitime ekonomike çojnë në rritjen e kapitalit (këtu nuk përfshihen rritjet, që lidhen me kontributet nga pjesëmarrësit në kapital).

Burimi kryesor i të ardhurave të një njësie ekonomike është shitja e mallrave dhe kryerja e shërbimeve. Burime të tjera, si: interesi, dividendët, dhe grantet qeveritare përbëjnë një element tjetër të të ardhurave.

Përbërja konkrete e të ardhurave sipas natyrës së tyre paraqitet si më poshtë:

70401	Te ardhura nga Punimet (Trema Enginering 2 sh.p.k)	LEK	23,874,759.00
70402	Punime per Mega Sh.p.k	LEK	22,644,953.50
70403	Te ardhura nga Punimet (Bolv-Oil sh.a)	LEK	9,533,172.50
70404	Te ardhura nga punimet (Bashkia Devoll)	LEK	469,426.00
705	Shitje mallrash	LEK	2,508,993.33
70711	Shitje materiale te para	LEK	11,485,867.71
	TOTALI	LEK	70,517,172.04

Në Pasqyrën e Performancës, PASH, shpenzimet janë paraqitur sipas natyrës së tyre për materiale, paga, tatime dhe taksa, amortizime dhe shpenzime të tjera. Të ardhurat kryesore janë nga kryerja e punimeve në objekte, punimet e të cilave janë të tenderuara direkt ose me nënkontraktim dhe nga shitja e mallrave.

Të gjitha llogaritë e të Ardhurave janë mbajtur me kartela analitike të veçanta dhe në to del qartë burimi se si janë siguruar këto të Ardhura.

Pasqyra e Flukseve të Parasë është ndërtuar sipas Metodës Indirekte ndërsa Pasqyra e Lëvizjes së Kapitalit është ndërtuar në bazë të të dhënave të regjistruara në kontabilitet sipas kërkesave të SKK Nr.2.

F) DISA SHPJEGIME NË LIDHJE ME DETYRIMET TATIMORE.

Në këtë Bilanc janë vendosur disa detyrime tatimore në pozicionin kreditor për të cilat ja vlen të sqarojmë si mëposhtë:

Vlera e TVSH në masën **481,337** lekë ndodhet në gjendje debitore.

Detyrimet janë për Sigurimet shoqërore dhe Tatimin mbi pagën që ka rrjedhur nga aktiviteti i muajit Dhjetor të vitit 2020 në masën **226,821** lekë, për Tatim Fitimin në masën **97,375** lekë, për Tatimin në Burim

SPARTAK SA SH.P.K
 NIP: 140000000
 TEL: 030 811 228 00
 BILISHT - ALBANIA

në masën 331,500 lekë. Në muajin Janar 2021 e në vazhdim ato janë likuiduar. Një natyrë të tillë ka edhe detyrimi i vendosur në bilanc për pagat e punonjësve

E) INFORMACION RRETH GJYKIMEVE DHE BURIMEVE KYÇE TË PASIGURISË SË VLERËSIMIT

Vlerësimi i inventareve si për AAM-të, për mallrat, për lëndët e para dhe për materialet gjendje më 31.12.2020 është i saktë. Pasiguri ka në vlerësimin e Kërkesave të Arkëtueshme dhe të Detyrimeve të Pagueshme të cilat kanë ndryshim për shkak të mënyrës së hartimit të kontratave të sipërmarrjes dhe për shkak të ndryshimit të projekteve të punimeve gjatë zbatimit të tyre. Vlera e gjendjes së llogarisë 455 është në masën 0.00 lekë.

Deklarimi i të ardhurave dhe i shpenzimeve ka një nivel të caktuar pasigurie e cila është relativisht e papërfillshme sepse është e saktësuar vlera e punimeve me kontratë paraprake dhe çmimi i shitjes me pakicë për të gjitha llojet e mallrave. Burimet e financimit të investimeve mbulohen disa herë tërësisht me fitimet neto të realizuara gjatë viteve ushtrimore prandaj kjo analizë për ne nuk përbën pasiguri. Gjithashtu pasiguri ka edhe për shkak se disa AAM mund të mos jenë regjistruar në llogaritë e shoqërisë por janë pronë personale. Pasiguri në vërtetësinë e të dhënave ka dhe për faktin se ndër vite mund të mos jenë deklaruar tërësisht huamarrjet dhe huadhëniet private apo marrëdhëniet e tjera financiare me palë të treta.

Pjesët përbërëse të Bilancit të shoqërisë "SPARTAK S.A" SH.P.K janë:

- | | |
|---|------------|
| • Pasqyra e Pozicionit Financiar | Dy fletë |
| • Pasqyra e Performancës | Një fletë |
| • Pasqyra e Flukseve të Mjeteve Monetare sipas metodës indirekte | Një fletë |
| • Pasqyra e Ndryshimeve në Kapitalet e Veta | Një fletë |
| • Listat e inventarëve të mallrave dhe të materialeve më 31.12.2020 | Një fletë |
| • Lista e inventarit të AAM-ve më 31.12.2020 | Një fletë |
| • Lista e gjendjes së llogarive më 31.12.2020 | Një fletë |
| • Tabela e llogaritjes së amortizimit për vitin 2020 | Një fletë |
| • Deklarata Vjetore e Tatimit mbi fitimin | Një fletë |
| • Inventari i llogarive bankare për vitin 2020 | Një fletë |
| • Tabela per Pasuri te Luajtshme (Makina) për vitin 2020 | Një fletë |
| • Tabela per Pasuri te Paluajtshme (Ndertesa) për vitin 2020 | Një fletë |
| • Pasqyra e analizës së TVSH-së për vitin 2020 | Një fletë |
| • Pasqyra Përmbledhëse e Sigurimeve për vitin 2020 | Një fletë |
| • Kontrata me Kontabilistin e Miratuar | Dy fletë |
| • Deklarata e Administratorit për hartimin e bilancit | Një fletë |
| • Shënime shpjeguese | Pesë fletë |

Shënim: Bilanci është hartuar në dy kopje dhe një kopje elektronike. Të gjitha janë të hartuara, të vulosura e të firmosura në të njëjtën formë.

Hartues
ANJEZA MAÇOLLI



Administrator
SPARTAK MERAKU

